



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Nr.01-060/01-1536/20 datë:20.01.2020



Npi – 01/28 datë: 30.01.2020

R A P O R T
I PUNËS TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHITIMES
PËR VITIN 2019

PËRMBAJTJA

<u>Hyrje</u>	<u>3</u>
<u>Qëllimi i Raportit</u>	<u>3</u>
<u>Mbledhjet e Kuvendit të Komunës</u>	<u>3</u>
<u>Komitetet e Përherëshme</u>	<u>4</u>
<u>Monitorimi i Mbledhjeve</u>	<u>4</u>
<u>Njoftimet për Mbledhje dhe Materialet Përcjellëse</u>	<u>5</u>
<u>Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës</u>	<u>6</u>
<u>Aktet e Kuvendit të Komunës</u>	<u>6</u>
<u>Publikimi i Akteve në Faqet Zyrtare Elektronike të Komunës</u>	<u>6</u>
<u>Shqyrtimi i Ligjshmërisë së Akteve</u>	<u>6</u>
<u>Aktivitetet Tjera</u>	<u>7</u>
<u>Përfundime</u>	<u>8</u>

Hyrje

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna. Komuna përmes organeve të saj është e obliguar të ushtrojë kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Ky sistem promovon sjelljen demokratike, transparente dhe llogaridhënien e organeve të komunës si dhe garanton një kontroll të ndërsjellë ndërmjet organeve komunale. Organet e Komunës janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë së tyre ta zhvillojnë sipas Kushtetutës, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe akteve nënligjore të organeve qendrore dhe akteve të cilat i nxjerrin vetë.

Në kuadër të organeve të Komunës, Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me legjislacionin për vetëqeverisje lokale. Kuvendi mbledhet rregullisht në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushëveprimtarisë së tij, për të miratuar aktet nënligjore të nevojshme për Komunën, të cilat kërkohen shprehimisht me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi i Raportit

Ky raport ka për qëllim informimin për nivelin e funksionimit të Kuvendit karshi mandatit ligjor, qytetarëve, organizatave joqeveritare, dhe çdo grupi tjetër të interesit. Përmes këtij raporti mundohemi të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre. Gjithashtu, raporti shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar rregullat e mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të siguroj njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Ky ligj ka normuar mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit.

Bazuar në këtë, Kuvendi ka përmbushur obligimin ligjor sipas nenit 43.2 të LVL-së për mbajtjen e 10 mbledhjeve të parapara gjatë vitit, 5 prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë. Kështu, Kuvendi i Komunës së Shtimes ka mbajtur **12** mbledhje të rregullta, **6** prej të cilave janë mbajtur në gjashtëmujorin e parë të vitit.

Sa u përket llojit të mbledhjeve, gjithsej janë mbajtur **12** seanca të rregullta, **1** seancë solemne, ndërsa nuk ka pasur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun duke përfshirë edhe mbledhjet e komiteteve.

Komitetet e Përhershme

Si rregull, mbledhjet e komiteteve mbahen para mbledhjeve të Kuvendit. Duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me LVL-s, komitetet shqyrtojnë agjendën e propozuar nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit, ofrimi i rekomandimeve, shqyrtimi i propozim-akteve dhe çështjeve të tjera të cilat parashihen për t'u trajtuar në mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Komiteti për Politikë dhe Financa: gjatë kësaj periudhe ka pasur rol të rëndësishëm në adresimin dhe trajtimin e çështjeve të ndryshme të cilat kanë qenë në interesin e përgjithshëm të komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa i ka trajtuar të gjitha pikat e rendit të ditës para se të kalojnë në diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Trajtim të veçantë Komiteti për Politikë dhe Financa ju ka kushtuar çështjeve të natyrës financiare, si: shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore të komunës, si dhe çështjeve të tjera në interes të përgjithshëm si: rregulloret komunale, dhënia e pronave të paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë etj.

Ky komitet, gjatë vitit 2019 ka mbajtur gjithsej **12** mbledhje të rregullta, ka aprovuar **2** vendime dhe ka dhënë **12** rekomandime.

Komiteti për Komunitete: si komitet i përhershëm, funksionaliteti i të cilit është i rëndësishëm së veçantë, gjatë mbledhjeve kanë diskutuar shumë çështje të cilat në thelb prekin jetën e secilit komunitet që jeton në komunën e Shtimes. Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Gjatë vitit 2019, Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej **12** mbledhje të rregullta, ka aprovuar **4** vendime dhe ka dhënë **8** rekomandime.

Monitorimi i Mbledhjeve

Monitorimi i mbledhjeve edhe gjatë këtij viti ka qenë i vazhdueshëm. Puna dhe angazhimi ynë është monitoruar nga OSBE-ja, Organizata Youth Association For Human Rights - YAHR, OJQ-të lokale, mediet lokale si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjellë punën dhe aktivitetin tonë përmes teleprezencës dhe verifikimit të ligjshmërisë së vendimeve tona.

Gjithashtu mbledhjet e Kuvendit janë incizuar me raste nga media lokale "SPIN TV", përmes së cilit janë transmetuar tek qytetarët. Në muajin dhjetor, komuna e Shtimes, ka filluar transmetimin online në faqen zyrtare të Komunës, "Komuna Shtime", në Facebook.

Njoftimet për Mbledhje dhe Materialet Përcjellëse

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës janë njoftuar paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftim është shënuar:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
- b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
- c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
- e) materialet e mbledhjes.

Nga muaji gusht, këshilltarët kanë qenë të pajisur me laptop, me qëllim të pranimit më të shpejtë të materialit, lehtësimit të casjes së tyre në dokumentet e nevojshme gjatë mbledhjeve, reduktimit të përdorimit të letrës dhe shpërndarjes së tyre fizike.

I njëjti njoftim që u është dërguar këshilltarëve komunal, i është shpallur edhe publikut.

Njoftimi dhe materialet gjithashtu i janë dërguar edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës

Në mesin e përgjegjësive të Kryetarit të Komunës është edhe raportimi para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare si administruer i financave të Komunës, lidhur me shpenzimet komunale, investimet kapitale, dhe shfrytëzimin e parasë publike. Bazuar në raportimet që ka paraqitur, Kryetari i Komunës e ka përmbushur obligimin për raportim në Kuvendin e Komunës brenda vitit, duke pasur gjithsej 4 raporte para Kuvendit. Forma e raportimit ka qenë me shkrim dhe ajo verbale, të cilat janë prezantuar para këshilltarëve. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit të Komunës.

Aktet e Kuvendit të Komunës

Në periudhën janar-dhjetor 2019, kuvendi ka trajtuar 97 pika të rendit të ditës duke miratuar 7 Rregullore Komunale, Korniza Afatmesme Buxhetore me dëgjimet buxhetore, Raporti dhe Plani Vjetor i Kuvendit dhe Kryetarit me atë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si dhe u miratuan 87 vendime, 1 vendim në parim. Gjatë periudhës 1 vjeçare të punës së Kuvendit pati 34 konkluzione dhe 1 konstatim.

Aktet e miratuara rregullojnë fushat e ndryshme të qeverisjes në nivelin lokal. Krahës kësaj janë diskutuar edhe shumë çështje në fusha të ndryshme si në arsim, shëndetësi, shërbime publike, mbrojtje të ambientit, sigurisë etj.

Publikimi i Akteve në Faqet Zyrtare Elektronike të Komunës

Si mjet kryesor për të ofruar qasjen e publikut në këto të dhëna, janë faqet zyrtare elektronike. Gjatë kësaj periudhe raportuese, të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë publikuar në gjuhët zyrtare në faqen elektronike të Komunës. Kjo mundëson qasjen e publikut në informacionet dhe ngjarjet e saj, si dhe krijon mundësinë për qasje më të lehtë në dokumentet zyrtare.

Shqyrtimi i Ligjshmërisë së Akteve

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoritet mbikëqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve për të cilat shprehimisht nuk është kompetent ndonjë autoritet tjetër.

Gjatë vitit 2019 të gjitha aktet e miratuara janë dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë në MAPL.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë, MAPL ka shqyrtuar të gjitha aktet e miratuara. Në kuadër të kësaj ka rekomanduar rishikimin e 7 vendimeve të miratuara. Bazuar në këto rekomandime, vendimet janë rishqyrtuar (po rishqyrtohen) dhe janë miratuar në përputhje me rekomandimet e MAPL-së dhe Komisioneve të Ministrive kompetente.

Aktivitetet Tjera

Krahas angazhimeve tona në Kuvend, ka pasur edhe aktivitete reprezentative edhe jashtë tij. Kryesuesja ka marrë pjesë në disa nga takimet që janë organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Ministrinë tjera, Asociacionin e Komunave, Kolegjiumin e Kryesuesve të Kuvendeve, me qëllim të shqyrtimit të problematikave, evidentimin e pengesave që hasen gjatë punës dhe gjetjen e formave për tejkalimin dhe lehtësimin e punës së Kuvendit në zhvillimin e politikave lokale.

Në vitin që po e lëmë pas, krahas angazhimeve të Kryesueses edhe këshilltarët kanë dhënë kontributin e tyre duke qenë të pranishëm në takimet e organizuara për këshilltarë të Kuvendit, duke marrë pjesë aktive nëpër trajnime e seminare.

Në këtë drejtim vlen të përmenden aktivitetet e organizuara nga: MAPL, OSBE-ja, Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me projektin DEMOS, USAID-i.

Përfundime:

- Ftesa, materialet e mbledhjes, afatet dhe njoftimet për mbledhje janë respektuar ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;
- Kuvendi i Komunës ka mbajtur numrin e mjaftueshëm prej 12 mbledhjeve të parapara gjatë vitit;
- Ka funksionuar sistemi i teleprezencës me qëllim të monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Gjithashtu mbledhjet janë monitoruar edhe përmes pranisë fizike të monitoruesve dhe media lokale;
- Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun;
- Gjatë mbledhjeve pothuajse në tërësi është respektuar Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe është bërë përkthimi i vendimeve në gjuhët zyrtare;
- Janë mbajtur takime publike me qytetarë- diskutimet buxhetore (jo pjesëmarrje të kënaqshme) etj;
- Është miratuar buxheti i Komunës;
- Kryetari i Komunës ka raportuar para Kuvendit të Komunës sipas nenit 58, pika (j);
- Aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë publikuar në faqet zyrtare elektronike;
- Pjesëmarrja e Kryetarit/Nënkryetarit të Komunës dhe ekzekutivit në mbledhjet e Kuvendit ka qenë pothuajse e përhershme;



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj